Lezhë, më 27.04.2022

# PROCESVERBAL

I mbajtur sot, më dt. 27.04.2022, në orën 13:00, në sallën e Qendrës kulturore të fëmijëve (QKF), mbi mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Lezhë, për muajin Prill 2022.

Mbledhja u hap nga kryetari i K.B. Lezhë z. Ernest Rokaj, i cili lexoi rendin e ditës si dhe 2 projekt vendime shtesë.

Agostin Marku: Me leje, për proceduren.

Si ka mundësi që përherë mbasi shpallet rendi i ditës, na vijnë projekt vendime shumë të rëndësishme që ndonjëherë kërkojnë dhe shumicë të cilësuar. Çfarë e pengon administratën e bashkisë që kur ka vendime të tilla për çështje pronësie apo për çështje buxheti t'i sjellë në kohë, kur e di shumë mirë se kur zhvillohet mbledhja e këshillit

E dyta, si rregull, edhe me rregulloren e miratuar por edhe me ligj, asnjë vendim nuk duhet të kalojë në këshill pa u mbledhur komisioni. Ne nuk shohim asnjëherë një relacion komisioni, që a duhet të kalojë ai projekt vendim.

Ernest Rokaj: Deri në një pikë ke të drejtë realisht. Komisionet janë mbledhur, por jo herë pas here. Disa kanë qenë neglizhentë dhe nuk i kanë mbledhur komisionet.

Sa i përket pikës së parë që shtrove, ke të drejtë, por projekt vendimi nuk ka qenë

gati, por është më me rëndësi që të kalohet, se se çështje e afatit, edhe pse është me shumicë të ulëšuar, edhe pse sot nuk e kemi shumicën e ulëšuar për ta kaluar këtë vendim. Ajo është diçka që i shërben shumë zonë.
* E kalojmë rendin e ditës në votim, ju lutem
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë përveç z. Agostin Malka që nuk votoi.
* Kalojmë te pika 1 e rendit të ditës, që është projekt vendim "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Mars 2022"
E hedhim në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
* Kalojmë te pika 2 e rendit të ditës, që është projekt-vendim "Për disa shtesa e ndryshime në VKB m. 157, dt. 17.11.2021 "Për miratimin e nivelit të taksave, tarifave vendore për shërbimet publike dhe ato administrative, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundravajtëve""
Rigels Nica: Bazuar në ligjin "Për Vetëqeverisjen Vendore", kemi të bëjmë me ndryshim buxheti dhe në Paketën Fiskale, që janë pikat 2 dhe 3 të rendit të ditës, në nenit 18. Thuhet që këshilli, përpara shqyrtimit dhe miratimit të tyre zhvillon seanca këshillimi

me qytetarët. A i keni zhvilluar ju si bashki konsultimet, pasi mund të bëhen dosjet e ketrimit të përgjigjes negative nga Prefekti? Për sa i përket shtyrjes së afatit të pagesave, besoj se është pozitive dhe është në ndihmë të biznesave

Eneda Molla: Kjo shtyrje afati është për t'i dhënë frymëmarrje biznesit

Ernest Rokaj: Janë bërë takime nga kryetari i Bashkisë edhe për pjesën e turizmit, edhe për pjesën e taksave, të postimit, për pjesën e mbarëvajtjes së sezonit turistik. Rigels nuk ka qenë prezent ti. Kjo nuk ka të bëjë me ndryshimin e tarifave, por thjesht do shtyhet si afat dhe kjo është një gjë e mirë për biznesin.

→ Doli këshilltari Alban Bruka.

Eneda Molla: Duke qenë se janë rritur çmimet, për t'i dhënë frymë biznesit, shtyhet afati me 1 muaj, i pagesës së taksave, deri në 30 qershor.

→ Doli këshilltari Gjin Kola.

Agostin Marku: Që jemi në periudhë krize dhe po ka rritje çmimesh, ky është fakt. Biznesi në tërësi ka probleme financiare. Bashkia nuk duhet të bëjë gjësme se po ndihmon biznesin. Bashkia mund ta ndihmonte biznesin edhe me shtyrje afatesh, por jo me kotë afat 1-mujor, edhe me ndryshim të Paketës Fiskale në disa zëra, kjo mund të jetë pak e

vështirë për bashkinë sepse është bërë parashikimi i të ardhurave në buxhet. Por nga do risimë të afoti, ne punemi si bashki turistike dhe si e tillë deri në Shtator biznesi është në shërbim. Do ishte mirë që mos ta linin me 1 muaj. Nuk ndodhet asgjë, përkundrazi, vetëm turbullohet situata. Një mesatare mund të fshihej, pra deri nga shtatori, në mbyllje të sezonit.

Enida Molla: Afatin e bëri pjesën, e dha vetë përgjigjen. Ne jemi në një situatë ku nuk mund të shtyjmë asgjë. Nuk është se nuk e duam.

Ernest Zeka: Meqë nuk ka diskutime të tjera e kalojmë projektet vendimin në votim.

Votohet PRO nga të gjithë këshilltarët prezentë në momentin e votimit.

- Kalojmë te pika 3 e rendit të ditës që është projekt-vendim "Për një shtesë e ndryshim në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2022 dhe përdorim të fondit të kontigjencës, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhet".
- Enida Molla: Ky është një fond i ardhur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për 5 punonjësit e projektit "Tungjatjeta Jetë"
- Rigels Nicaj: Nisur nga p/vendimi, kuptohet se MSHMS i ka transferuar një fond Bashkisë Lezhë. Kush e ka përcaktuar numrin e punonjësve që duhet shtuar, Ministria apo Bashkia.

Dhe e dyta, fondi i dërguar nga Ministria nuk i përgjigjet për 5 punonjës. A mos e ke dërguar më pak?

Enida Molla: Jo, është për 5 punonjës, por është viti i tretë i projektit dhe në fillim kur është bërë marrëveshja ke parë që në vitin e tretë, 70% do e përballojë ministria dhe 30% do e përballojë bashkia. Pra numri i punonjësve ke parë i njëjtë që nga viti i parë deri në vitin e tretë, por vitin e parë e ke mbuluar 100% ministria, vitin e dytë ke parë 80 me 20, ndërsa vitin e tretë është 70 me 30.

Ernest Rakaj: Meqë nuk ka diskutime të tjera, e kalojmë projekt-vendimin në votim. Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë. Kalojmë te pika 4 e rendit të ditës që është projekt-vendim "Për miratimin e kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij".

→ Kryetari i dha fjalën znj. Gjystina Nikolaj, përfaqësuese e Drejtorisë së Arsimit dhe Sportit e cila dhe shpjegoi sipas relacionit përkatës.

Afestin Marku: Pse 4-6 anëtarë.

Duhet përcaktuar saktë numri, madje

duhet numër tek. Ligji ia lë organit vendimmarrës hapësirën për të vendosur. Aty thuhet se duhet edhe një përfaqësues i këshillit.
Pra, atëherë të lëmë numrin 6 dhe në procedurat e mëvonshme të caktohet Rigels Nicaj, si këshilltar.
Ernest Rukaj: E hedhim për vendimin në votim
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kalojmë te pika 5 e rendit të ditës që është projekt-vendim "Për miratimin e prioritetit për ndërtimin e një tregu për produktet bujqësore".
- Kryetari i dha fjalën z. Elson Frroku, drejtor i Programeve të Zhvillimit, i cili dha shpjegime sipas relacionit përkatës të përgatitur.
Ernest Rukaj: Kush do e administrojë?
→ Doli këshilltarja Vera Pica.
Elson Frroku: Për sa i përket administrimit, kjo do jetë në një moment të dytë
Ndoshta nuk u shpjegova dot si duhet.
Tani bëhet fjalë për miratimin e prioritetit.
Rigels Nicaj: A është marrë mendimi i grupeve të interesit?
Është edhe tregu te rruga e Rrilës dhe është kot.
Të bësh midis Lezhës treg....
Ka plot gjëra të bukura që mund të bëhen për ata banorë.
→ Doli këshilltari Ardian Nikulaj.
Rigels Nicaj: Na u bënë fëmijët obezë duke

ndenjur në shtëpi.
Mu përballë çerdhes, në vend që të bëhet diçka për fëmijët aty.
Apo .. Lezha mben për parkim.
Argjentjana Ndoka: Veç ankesa qytetarësh se do vijnë.
Elson Firoku: Konsultimi është pjesë e strategjisë së përgjithshme të Bashkisë.
Për sa i përket peshkut, produkteve të mishit, nuk janë.
Bëhet fjalë për produktet e zonës,
Sa për parkimin, te pallati i ri te Besëlidhja është parkimi nëntokësor.
→ Doli këshilltarja Merita Lika
Rigels Nicaj: Të diskutojmë se bëhet fjalë për t'ua lënë fëmijëve tanë në mes të Lezhës.
Ernest Rakaj: Megjë kuorumin e nevojshëm nuk e kemi, unë mendoj të shtyjmë për herën tjetër, duke qenë prezent edhe Kryetari i Bashkisë.
Agostin Marku: Lezha ka nevojë për një treg të tillë, me parametra bashkëkohore, por ngutërim bën relacioni me plan vendosje.
Tregje të tilla nuk duhet të jenë në mes të qytetit.
Elson Firoku: Ky projekt-vendim, kam diskutuar edhe Sekretaren e Këshillit, është përfunduar pak para mbylljes së rendit të ditës.
Bëhet fjalë për një fond 300 mln lekë dhe vendimi i këshillit, po të kalonim

sot, do ishte një bonus për të fituar fondin.

<u>Ernest Roka</u>": Në orën 13$^{00}$ ditën e nesërme e lëmë të mblidhemi për 3 projektet – vendimet që mbetën pa u miratuar për mungesë kuorumi.
Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
Ernest Roka

Lezhë, më 28.04.2022

# PROCES VERBAL

I mbajtur sot, në dt. 28.04.2022, në orën 13:30, mbi shtyrjen e shqyrtimit të 3 projekt-vendimeve nga mbledhja e radhës e KB Lezhë e datës 27.04.2022.

Në mbështetje të Nenin 75, pika 4, të Rregullores së funksionimit të KB Lezhë, pasi u prit nga kryetari i këshillit mbi 30 minuta që të plotësohej kuorumi, u vendos që mbledhja e këshillit të shtyhet për në dt. 04.05.2022, në orën 13:00.

SEKRETARI
FLORIDA CUNAJ

KRYETARI
Ernest Raka

Lezhë, më 04.05.2022

PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 04.05.2022, në orën 13:00, në sallën e QKF.

Mbledhja zhvillohet për shkak të mungesës së kuorumit në shqyrtimin e 3 projekt-vendimeve në datat 27.04.2022 dhe 28.04.2022.

Mbledhja u hap nga kryetari i K.B. Lezhë, z. Ernest Rakaj i cili deklaroi ekzistencën e kuorumit dhe lexoi 3 projekt vendimet për shqyrtim.

Kryetari hodhi në votim rendin e ditës, i cili u miratua nga të gjithë këshilltarët prezentë, përveç z. Agostin Marku që nuk votoi.

- Kryetari filloi me pikën e parë të rendit të ditës që është projekt-vendim "Për fillimin e procedurave për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pronës nr. 95/11, e regjistruar në kartelën e pasurive të paluajtshme me nr. vol. 4 fq 60, ZK 1716, fshati Gjadër, indeks harte 84-C, në favor të Bashkisë Lezhë".

→ Erdhi këshilltari Alban Bruka

- Kryetari i dha fjalën zv/kryetarit të Bashkisë z. Ermal Pacaj, i cili dha shpjegime në lidhje me p/vendimin sipas relacionit përkatës.

- Kryetari i dha fjalën këshilltarit Rigels Nicaj.

Rigels Nicaj: Realisht problemi i varrezave është një problem i madh dhe krahas miratimit, në një moment të dytë të bëhet edhe sistemimi e përcaktimi i këtyre varreve sepse po nuk u bë, vjen momenti që të zihet toka me 4 varre.

Të ketë një farë rregulli, t'i shikojë dikush, të ketë edhe një përgjegjës.
Ermal Pacaj: Pjesa e varrezave përndron si problem dhe është një prej problemeve më emergjente që ne kemi.
Nuk është vetëm problemi i amortizimit të infrastrukturës të disa varrezave në disa fshatra, te të gjitha po ndërhyhet. Njëkohësisht është edhe problemi me hapësirën, p.sh. në fshatin Rrilë praktikisht ka mbaruar hapësira, në Kodër Marlekaj thuajse ka buyer dhe ajo.
Është problemi me hapësirën sepse hapësirë shtet nuk ka. Privatët ne nuk i blejmë dot, vetëm n.p.s i shpronësojmë. Shpronësimi është shumë shumë i ulët. Po shohim të gjejmë një zgjidhje.
Për varreza të reja, në Rrilë p.sh, nuk ka vend më.
Argjentjeno Ndoka: Është një problem që duhet parë nga bashkia.
Ermal Pacaj: Gjoni, nuk duhet parë nga bashkia, por është detyrë e bashkisë. dhe Bashkia e Lezhës për 30 vjet nuk e ka vrarë mendjen.
Mark Simoni: Duhen varrezat murale.
Ermal Pacaj: Është koncept shumë avangard ai i varrezave murale për Shqipërinë.
Agostin Marku: Siç e shikoni, ne për tjetër gjë duhet të vendosim sot dhe për tjetër gjë diskutojmë. Në projekt-vendim nuk ka kund asnjë fjalë që të flasë për varrezat ndërsa

i gjithë relacioni flet për vërtetet

→ Erdhi këshilltari Klejvi Hoxhiqi.

Agostin Marku: Dhe sipas deklaratave të zv/kryetarit të bashkisë, nuk duhet e gjithë sipërfaqja por duhet një pjesë dhe institucioni tjetër thotë: merre të gjithën, se ai do ta shkarkojë. Është në të drejtën e tij dhe ai. Nga ana tjetër themi është bërë një herë tjetër një kërkesë nga bashkia, pa marrë autorizim. Tani, për të marrë të tërën, na duhet autorizim.

- Ermal Pacaj: Nuk e kemi bërë ne këtë.

Agostin Marku: Unë nuk thashë se e ke bërë ti. Bashkia. Bashkia është institucion, si sot, si para 5 viteshë. E keni gjetur në proces. Unë e kam menduar më tepër te përputhja e relacionete me projekt vendimet. Se njëkohësisht fusim në porosokeli kujt vendimmarrjen, jo për projekt vendimin, këtë që na e bën relacioni që na fut në porsokeh. Ashtu si kur vijmë te tregu, tjetër që thotë relacioni, tjetër që thotë projekt vendimi. Jeni të lutur z. Ermal, merreni si këshillë, një bashki që ka 400 e ca punonjës, është në gjendje që t'i rregullojë ca marrëdhënie në mes të sektorëve të bashkisë, që kur të na vijnë p/vendimet këtu, të vijnë të gjitha me një uniformë

→ Erdhi këshilltari Hasan Muça

→ Doli këshilltari Emirjon Lezri

Agostin Marku: Dhe sektori që mund ta bëjë

këtë gjë, që që të jemi ok me ligjin dhe ne me vendimmarrjen, është sektori juridik.
Edhe sot në marrjen e vendimit, pedrejtësisht i referohemi kalimit të së drejtës së pronësisë, që kërkon shumicë të cilësuar. Në gjykimin tim, por edhe po t'i referohemi ligjit, kjo nuk ka nevojë për shumicë të cilësuar sepse kemi të bëjmë me fillim procedurash, pra ne s'po kalojmë pronën sot.
Ernest Rokaj: Nuk e tha kush
Agostin Marku: S'e ke thënë ti, e kanë pra këtu.
Meqë jemi këtu dhe më jep një të drejtë edhe relacioni për ta thënë, unë kam një pyetje.
Ministria e Mbrojtjes thotë i merre të tërën.
Ne na duhet një pjesë për varreza. Bashkia meqë e ka zgjidhë çështjen e varrezave këtu, këtë pjesën tjetër për ça mendon ta përdorë?
Ermal Pacaj: Unë shoh që relacioni është shumë i qartë në lidhje me projekt vendimin.
Ok, neni 54 që është përfshirë këtu, edhe unë e shoh që nuk ka nevojë të jetë fare këtu.
Pjesa që është aktualisht e zënë, është më shumë se gjysma e asaj gjysmës. Praktikisht, gjithë ajo pjesë do i shërbejë fshatit Gjedër për varreza, por do këtë edhe për 15-20 vitet e ardhshme, duhet gjithmonë me atë objektiv. Kjo është ideja. Nuk është se ka ndonjë qëllim tjetër.
Ernest Rokaj: E kalojmë projekt vendimin

në votim meqë nuk ka diskutime të tjera.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë
përveç z. Agostin Marku që nuk votoi.
- Kalojmë për shqyrtim te pika e dytë e rendit
të ditës që është projekt vendim "Për përdorimin
e Fondit të Kontigjencës, për mbulimin e shpenzimeve
të paparashikuara në buxhetin e vitit 2022".
Ky është një projekt vendim që na ka ardhë
nga Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve
dhe ka të bëjë me ngritjen e Qendrës Rinore
Lezhë, ku me sa kam info unë është kaluar
fondi 90%, por që të kalojë dhe pjesa tjetër
që të jetë 100%.
Agostin Marku: ky 10% është nga të ardhurat
e bashkisë.
Ermal Pacaj: 100% e fondit të marrë nga
Agjencia Kombëtare e Rinisë është i gjithi
nga AKR, jo nga Bashkia Lezhë, por çfarë
ndodh, ata kanë adresuar te ne vetëm 90%
të fondit dhe 10%-shin e fundit e japin
mbasi të kryhet puna, që mbahet si garanci
që puna të kryhet, mirëpo meqë neve na
duhet të bëjmë procedurën, ne na duhet që
këtë 10%-sh të paguajmë nga fondet e bashkisë
që pastaj kur të vijë 10%-shi ta marrim e
të përdorim aty ku e kemi hequr në këtë
rast.
Agostin Marku: Dhe e dyta zoti ZV/Kryetar.
Nuk bëjmë rikonstruksion të Qendrës Rinore.

Qendra Rinore është diçka abstrakte, nuk është objekt

Ermal Paço: Në fakt duhet të ishte "Rikonstruksion i objektit me pëllim ndërtimin e Q.R". Po, ke të drejtë.

Sot ne nuk kemi Q.R. por kemi një objekt që do të rikonstruktohet për t'u bërë Qendër Rinore te "Hydajet Lezha".

Ernest Rakaj: Meqë nuk ke diskutime të tjera, e hedhim projekt-vendimin në votim

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.

Kalojmë për shqyrtim te pika e tretë e rendit të ditës që është projekt-vendim "Për miratimin e prioritetit për ndërtimin e një tregu për produktet bujqësore".

I japim fjalën të/Kryetarit të Bashkisë.

Ermal Paço: AZHBR-ja ka hapur thirrje për aplikime për një seri tërësh që ata mendojnë të financojnë për bashkitë.

Ne kemi menduar që të aplikojmë për një treg agroushqimor. Në fakt ne e kemi një treg të tillë në ish ngjësinë e Kolshit. Është një histori e gjatë se pse ajo nuk është vënë në eficiencë. Përgjigja e fundit që ne kemi marrë ishte, aplikoni për legalizim sepse ajo ka qenë bërë atëherë bashkëpunim mes Komunës së Kolshit, Komunës së Zejmenit, me lejë të këshillit të Qarkut që nuk gjendet më për të shkuar për të bërë regjistrimin

Nuk e kuptoj se si mundet një institucion Shtetëror të bëjë aplikim për legalizim. Ajo nuk është zgjidhur akoma dhe kemi menduar të aplikojmë në AZHBR për një treg agroushqimor, po jo domosdoshmërisht duhet të ndërtohet aty ku ka pasë destinacioni, po është në relacion, te pjesa mes pallateve te Rrugës "Besëlidhja". Në qytet nuk ka hapësira shtet ku mundemi të operojmë, për të aplikuar, por kemi menduar po të bëjmë një stacion të përkohshëm, të paktën se për aplikim aty dhe e shohim më përpara n.q.s është mundësie po të ndërtohet diku tjetër.
Në komunikim me drejtorinë përkatëse po ka bërë projekt vendimin lindi pyetja po e mund të ndryshohet vendi mbas miratimit të këshillit dhe ata më thanë po.

Rigels Nicaj: Asnjëherë ne nuk mund ta shkatërrojmë vendin duke ba një treg midis vendit. Ok se digjet fondi por jemi edhe pak i fiksuar se paralel me fondin ata na ngelet dhe ky miratimi jonë dhe të shohim tregun duke lulëtuar në një rrugë me një sens kalimi, në një rrugë me 3 m gjatësi dhe atë tokë që akoma nuk e kemi kalu në pronësi të Bashkisë dhe prapë se prapë ne jemi në kundërshtim se dhe ajo tokë ka procedurë, se dhe ajo godinë po

është lënë pa u pirë [?] aty, është lënë për një arsye.
E kam thënë dhe herën tjetër, Lezha ka nevojë për ndonjë ambient sportiv, ka nevojë për një parking, ka nevojë për një ambient ku ne të çojmë fëmijët, se boll e kanë betonizuar Lezhën. Të paktën kjo hapësirë për neve na ka mbetur në negociatë të përdoret për këto qëllime.
Unë kam qenë dhe jam kundër pjesës së vendndodhjes.
Ermal Pacaj: Duhet një vend për të aplikuar. Ajo është diçka që mund edhe të mos bëhet se ne e aplikojmë dhe nuk e fitojmë.
Në mos sot, nesër, tregun agroushqimor që kemi në Barbullojë, ne do e vëmë në efiçiencë.
Argjenthena Noka: Në Barbullojë është larg sepse normalisht shumë qytetarë nuk kanë mjete për të lëvizur
Duhet gjetur një vend sa më i përshtatshëm
Arben Ndreu: Është e parealizueshme sepse është shumë pak vend.
→ Erdhi këshilltari Visar Alia
Ermal Pacaj: Thirrja e AZHBR-së është për të stimuluar bujqit. Ne nuk po flasim për një treg të mirëfilltë agroushqimor.
Faza e parë e aplikimit është projekt ide
Faza tjetër, n.q.s kualifikohemi ka gjërat e tjera.

→ Erdhi kryetari i Bashkisë z. Pjerin Ndreu.
- Këshilltari Rigels Nicaj bëri të njëjtin diskutim në prezencë të kryetarit të Bashkisë.
Pjerin Ndreu: Me thënë të drejtën, as unë nuk kam qejf ta bëjmë aty.
Po kërkojmë një vend tjetër.
Është për efekt aplikimi, për të fituar fondin e AZHBR-së.
I hapur jam, nqs do gjejmë vend tjetër.
Do parë, nëse lejohet të ndryshohet vendi mbas fitimit të aplikimit.
Rigels Nicaj: Po këtu mbrapa te vendvarrimi i Skënderbeut, por jo përballë Qerokes
Pjerin Ndreu: Unë propozoj ta kalojmë në parim, mos ta zbardhim dhe ta verifikojmë a lejohet të ndryshojë vendi.
Agostin Marku: Më mirë mos ta kalojmë atë fond 300 mln sesa ta miratojmë që të bëhet atje.
Pjerin Ndreu: Unë mendoj që trep atje nuk duhet të bëhet. Kur ma sollën, më thanë është se për aplikim. Elsoni që është marrë me atë punë, më konfirmon që është se për aplikim. Unë u thashë, në Torovicë ose në Mabë, por a grumbullohet apo jo.
→ Doli këshilltari Kristjan Leka.
Pjerin Ndreu: A e kalojmë në parim dhe atje nuk do e bëjmë
Ernest Rrokaj: Meqë nuk ka diskutime të tjera,

e kalojmë projekt vendimin në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë
përveç z. Agostin Marku që nuk votoi.
Kalojmë te pika të ndryshme.

→ Doli këshilltarja Megi Çupi
→ Doli këshilltari Hasan Muça

Filloi diskutim dhe pyetje nga këshilltarët
drejtuar kryetarit të Bashkisë.

Në fund kryetari z. Ernest Rakaj deklaroi
mbledhjen të mbyllur.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
Ernest Rakaj